



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 06, datë 29.10.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTET: “ZGJERIM I STACIONIT EKZISTUES VODAFONE 133 RROGOZHINA DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËS EKZISTUESE”, ME VENDODHJE NË FSHATIN THANASAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE DUSHK, BASHKIA LUSHNJE.

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e subjektit kërkues, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektet: “Zgjerim i stacionit ekzistues Vodafone 133 Rrogozhina dhe rikonstruksion i rrugës ekzistuese”, me vendodhje në fshatin Thanasaj, Njësia Administrative Dushk, Bashkia Lushnje, me subjekt kërkues “Hellas Service” sh.p.k.
2. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) pajisjes me dokumentin përkatës mjedisor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



A circular blue ink stamp from the Ministry of Urban Development in Tirana, Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE", "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT", and "TIRANË". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

SEKRETARE E KKT

LEDIA TOTA



A circular blue ink stamp from the Agency for Territorial Development in Tirana, Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE", "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT", and "TIRANË". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

DREJTORE E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

